



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;

E-mail: [klsh.org.al](mailto:klsh.org.al); Web-site [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

Nr. 1153/20 Prot.

Tiranë, më 15.09.2021

**V E N D I M**

**Nr. 113, Datë 15.09.2021**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË AUTORITETIT  
KOMBËTAR TË USHQIMIT, QARKU TIRANË  
"MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË",  
për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar (në vijim DRAKU), Qarku Tiranë rezultoi që, veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim të çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të institucionit për procedurat e inspektimit, administrimin e mallrave të sekuestruar, të aktivitetit ekonomiko-financiar, **nuk ka rezultuar efektive**, si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e procedurave në përputhje me kuadrin ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi funksionimin dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare (Auditim Përputhshmërie)", të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Qarku Tiranë, sipas programit të auditimit nr.1153/1, datë 05.01.2021, i ndryshuar me shkresën nr.1153/2, datë 06.01.2021 dhe me shkresën nr.1153/3, datë 03.02.2021, për veprimtarinë nga data 01.01.2018 deri më datën 31.12.2020.

**II.** Të miratoj Opinionin e auditimit, rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## A.OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinion i kundërt<sup>1</sup>**

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së DRAKU Tiranë për periudhën 01.01.2018-31.12.2020, nëse kjo veprimtari është kryer duke respektuar dhe zbatuar ligjet, rregulloret në fuqi, marrëveshjet, duke përfshirë këtu shpenzimet/investimet vjetore të buxhetit, kryerjen e inspektimeve, zbatimin e kuadrit ligjor për vendosjen e penaltiteteve, sekuestrimin e mallrave dhe administrimin e tyre, që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të DRAKU Tiranë, ku rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), si pasojë e mospërmbushjes së detyrave funksionale të institucioneve të auditimit.

*Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin DRAKU Tiranë rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave mbështesin dhënien e një **opinionit të kundërt**.<sup>2</sup>*

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së zbatimit të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur u evidentua se, aktiviteti i kryer nga DRAKU Tiranë për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, administrimin e vlerave monetare e materiale, planifikimin dhe kryerjen e inspektimit për produktet me origjinë shtazore, joshtazore dhe bimët, vendosjen e masave administrative, shqyrtimin dhe arkëtimin e tyre, veprimtarinë e sektorit të laboratorit përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.2020, nuk ka qenë në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi, duke mos përmbushur detyrat funksionale të institucionit, të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur, janë materiale dhe të përhapura.

### **Baza për opinionin e përputhshmërisë.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave, me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e transaksioneve. Konkretisht në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

-Në 56 raste nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbauesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likuidim vullnetar, kërkimi nga përmbauesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve) dhe për pasojë ndaj buxhetit të shtetit janë krijuar të ardhura të munguara në vlerën 29,958,000 lekë, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë 23 gjoba, përkatësisht në vlerën 18,334,000 lekë gjithsej, për të cilat është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.

<sup>1</sup> Sipas **Manualit të Auditimit Përputhshmërisë** të KLSH-së, miratuar me Vendimin nr.66, datë 23.06.2020, grupi II pika 7.3.3, *Opinion të kundërt nëse aspektet e mospërputhjes janë materiale dhe të përhapura.*

<sup>2</sup> Neni 4, pika 2, shkronja b, paragrafi i tretë “Opinion i kundërt, jepet në ato raste kur është marrë siguri e arsyeshme, është siguruar një evidencë e mjaftueshme dhe e plotë, por devijimet e pajtueshmërisë janë materiale dhe të përhapura”, në Rregulloren e Procedurave të Auditimit, miratuar me Vendimin nr.63, datë 22.06.2020, të Kryetarit të KLSH-së.

-Në 21 raste në vlerën 31,550,000 lekë, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjambat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, në mungesë të kompetencës ligjore, arsyetimit ligjor dhe jashtë afatit;

-Në 3 raste, nga Komisioni pranë DPAKU, janë shfuqizuar gjambat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i kanë lënë në fuqi, duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë;

-Në 2 raste për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare, nga momenti i vendosjes së gjobave, nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin dhe arkëtimin, duke sjellë parashkrimin e tyre dhe heqjen e të drejtës për arkëtim, me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë;

-Në 59 raste, procedura e asgjесimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 69 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, pasi në këto praktika nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjесimit, si procesverbali i asgjесimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjесimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill.

-Në 35 raste nuk dokumentohet me shenja dalluese bllokimi i produkteve ushqimore dhe më pas administrimi i tyre.

-Në 18 raste është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre.

-Në 12 raste është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat kanë qenë në shkelje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambientet e subjekteve private, në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të DRAKU Tiranë:**

Drejtimi DRAKU Tiranë, është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjithë bazën ligjore dhe rregullatore në fuqi.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të DRAKU Tiranë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Ne komunikua me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë. Ne identifikua çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruam ato në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kundërt.

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në **21 raste** në vlerën **31,550,000 lekë**, nga ky Komision janë shfuqizuar tërësisht/pjesërisht gjambat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, nga të cilat në:

-**14 raste** për subjektet (S.D.T, A.F, F.B, T.C.C, T.A, T.P, L.H, K.F.T, M.N, M.S.D, Y.M, L.S), në vlerën **21,350,000 lekë** gjithsej, janë shfuqizuar gjambat në mungesë të kompetencës ligjore dhe jashtë afatit, 2 raste prej tyre. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*

-**5 raste** për subjektet (A.B, B.N, O.C, C.A), në vlerën **8,650,000 lekë** në mungesë të arsytimit ligjor nga Komisioni përkatës pranë DPAKU. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

-**2 raste** për subjektet (I dhe N), në vlerën **1,550,000 lekë**, janë shfuqizuar gjambat, ndërkohë që ato kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, pra Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat nuk ka patur ende vendim përfundimtar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*

Këto veprime nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 dhe 5 të nenit 91, nenin 99 dhe 100, të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Nenin 36 dhe nenin 449 të “Kodit të Procedurës Civile në RSH”, i ndryshuar, shkronjat “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, “i”, “k”, të pikës 1 të nenit 68, pikat 1 dhe 2 të nenit 70/1 dhe nenin 73 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, si dhe Kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 “Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin”. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4, 2.5 dhe 2.10) faqe (27-140; 140-191 dhe 256-266) të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë dhe DPAKU në bashkëpunim me MBZHR, në mbështetje të neneve 111, 113 dhe 114 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të marrin masat e nevojshme, për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të mësipërme për 21 gjambat, me qëllim anulimin e tyre dhe rivendosjen e ligjshmërisë, si dhe përcjelljen 19 gjobave (përfshirë 2 gjoba të cilat janë në shkallën e dytë të gjykimit) pranë Komisionit të posaçëm në MBZHR për shqyrtimin nga e para dhe vendimmarrje të mëtejshme.

**1.2.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, **për 2 gjobat**, të cilat kanë qenë në shkallën e dytë të gjykimit, të marrin masat e nevojshme për ndjekjen e ecurisë së procesit në Gjykatën Administrative të Apelit.

**Menjëherë**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën përcjellëse nr.557/10, datë 22.09.2015, nuk janë zbatuar rekomandimet si më poshtë vijon:

Rekomandimi 1: “MBZHRAU dhe DPAKU të marrin masa për përcaktimin e standardeve ushqimore të çdo produkti dhe tarifave të tyre, referuar Udhëzimit nr.8, datë 08.05.2007 “Për përcaktimin e tarifave të të ardhurave dytësore”.

Rekomandimi nr.2:DPAKU të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mos apelimin e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, në dy raste të pagesave të punonjësve të larguar nga puna.

Rekomandimi nr.3:DRAKU Tiranë të marri masat për certifikimin e laboratorit.

Rekomandimi nr.5:DRAKU Tiranë të përgatitë dokumentacionin ligjor të pronësisë për objektin që i është vënë në dispozicion nga MBZHRAU, si dhe të bëjë kontabilizimin e saj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.1) faqe (17-20) të Raportit të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** Titullari i DRAKU Tiranë për rekomandimet nr.1, 2, 3 dhe 5 të lëna në auditimin e mëparshëm, të marrë masat e nevojshme për analizimin dhe vlerësimin e mundësisë së zbatimit të tyre.

**Menjëherë**

**3.Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, i ndryshuar dhe me urdhrin e Drejtorit Përgjithshëm nr. 2363 datë 30.03.2018, DRAKU Tiranë **nuk ka dorëzuar pranë rezervave shtetërore për ankand, pajisjet dhe sendet sekuestruara/konfiskuara**, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, por ato qëndrojnë prej 3 vitesh në magazinën e AKU, në dëm të biznesit dhe administrimit tyre. DRAKU Tiranë pajisjet e konfiskuara ndaj 18 subjekteve në vitin 2018 i ka dorëzuar pa vlerë duke i pasqyruar vetëm në sasi. Padrejtësisht në flet hyrjen nr. 2 datë 07.05.2018 të AKU thuhet se: 5 frigoriferët janë jashtë përdorimit, sepse nuk argumentohet me dokumente, pasi mungon procesverbali i specialistit fushës dhe pasqyra e amortizimit si dhe viti blerjes. Gjithashtu pajisjet jo në gjendje pune nuk konfiskohen sepse janë objekt nxjerrjes jashtë përdorimit. Për rrjedhojë frigoriferët që pretendohen se janë jashtë përdorimit nuk mund të kalojnë në rezervat shtetërore, pasi bie ndesh me pikën 4/c te UKM nr. 1 datë 18.02.2015. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marrë masa për kalimin në pranë rezervave shtetërore të pajisjeve dhe sendeve sekuestruara/konfiskuara, përkatësisht 5 frigorifer, 3 peshore, 80 çengela, 6 thika, 5 hanxharë, sipas flet hyrjes nr.2 datë 07.05.2018 të AKU.

**Menjëherë**

**4.Gjetje:** Plani vjetor i inspektimit, nuk është hartuar sipas standardeve të kërkuara nga Inspektorati Qendror me tematikë inspektimi dhe parashikimin e numrit të përgjithshëm të inspektimeve që do të kryhen, si dhe programet mujore për periudhën 2018-2020 nuk janë hartuar, miratuar si dhe nuk janë dërguar për mendim në Inspektoratin Qendror, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në VKM nr.696, datë 16.08.2013 dhe Urdhrit nr.6, datë 19.02.2015 të Inspektorit të Përgjithshëm;

-Në metodikën për përcaktimin e riskut të subjektit, frekuencën e inspektimeve dhe marrjen e mostrave për analizë laboratorike, nuk merret në konsideratë, si faktor vlerësues, historiku i subjektit<sup>3</sup>, ç’ka në gjykimin e grupit të auditimit, marrja e tij në konsideratë, është e rëndësishme, pasi në subjektet, të cilat në rreth 3 vitet e fundit nuk kanë patur shkelje ligjore përgjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre, mund të reduktohet numri i inspektimeve vjetore, duke siguruar në këtë mënyrë përdorimin eficient të burimeve njerëzore.

-Për 26 subjekte me aktivitet të madh nuk janë planifikuar për inspektim dhe nuk është kryer inspektimi i tyre për një periudhë 2-3 vjeçare, duke diferencuar subjektet, pasi disa subjekte janë inspektuar deri në 30 herë në vit. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

**4.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, për subjektet e inspektuara në 3 vitet e fundit, të bëjë një vlerësim të sjelljes së tyre ndaj respektimit të kërkesave ligjore, si dhe në bazë të këtij vlerësimi, të bëhet ndryshimi i kategorizimit të riskut të tyre (i lartë, i mesëm, i ulët) e për rrjedhojë edhe frekuenca e inspektimit të tyre.

**4.2.Rekomandimi:** Gjithashtu në planin vjetor të planifikohen të gjitha subjektet për inspektim pa diferencime, si dhe ai dhe planet mujore ti përcillen për mendim Inspektoratit Qendror dhe më pas të miratohen nga titullari i institucionit.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

<sup>3</sup> Pika 2.6, kapitulli II programimi i veprimtarive të inspektimit, Urdhëri nr.13, datë 23.4.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.

**5.Gjetje:** Laboratori i DRAKU Tiranë, tashmë në varësi direkte të DPAKU-së, ende nuk është i akredituar<sup>4</sup> për kryerjen e analizave të produkteve me origjinë shtazore dhe joshtazore<sup>5</sup>. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

**5.1. Rekomandimi:** DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë të marrin masat e nevojshme që të fillojnë procesin e akreditimit të laboratorit.

**5.2. Rekomandimi:** DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë të marrin masat për kryerjen e investimeve të nevojshme në përmirësimin e kushteve të laboratorit (dhoma e pranimit dhe e qëndrimit të mostrave, sistemin e kondicionimit, aspirimit), si dhe kalibrimin dhe vënien në funksion të plotë aparaturave laboratorike, me qëllim rritjen e saktësisë dhe besueshmërisë së rezultateve të analizave laboratorike.

#### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

**6.Gjetje:** Ndërmjet sektorit të laboratorit dhe atij të inspektimit në DRAKU Tiranë ka munguar koordinimi në përcaktimin e treguesve mikrobiologjik që duhet të analizohen për një mostër të kontrollit zyrtar, ku theksojmë se treguesi që do të analizohet përcaktohet nga inspektori dhe jo nga specialisti i laboratorit, referuar këtu edhe përcaktimit të bërë në Urdhrin nr.261, datë 10.09.2009 “Për miratimin e rregullores mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** DPAKU të marrin masat e nevojshme që për çdo mostër të sjellë nga kontrolli zyrtar, treguesit që do të analizohen të përcaktohen nga specialistët e laboratorit, si dhe nga inspektorët në fletë-shoqërimin e mostrës të përcaktohet qartë se në çfarë kushtesh është ruajtur produkti prej nga është marrë mostra, duke shërbyer si tregues për laboratorin në përcaktimin e treguesit që do të analizohet.

#### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

**7.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit të produkteve me origjinë shtazore, në **12 raste** është konstatuar se produkti mish, i cili është konfiskuar gjatë inspektimit të subjekteve, të cilat kanë qenë në shkëlqje të ligjit, nga inspektorët është dërguar në ambjentet e subjekteve private, si B.Z.F sh.p.k., dhe K sh.p.k., në një kohë që këto subjekte janë vetë objekt inspektimi nga DRAKU Tiranë, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën ç të pikës 2 dhe pikën 3 të nenit 43, të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, si dhe përcaktimit të bërë në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 11 të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. Theksojmë se ky veprim është kryer në tejkalim të kompetencave ligjore, pasi për kryerjen e tij, (pra mishin e konfiskuar ta dërgosh në ambjentet e një tjetër subjekti privat), nuk ka patur minimalisht as edhe një kontratë qiraje për dhomë/magazinë frigoriferike, ndërmjet AKU dhe këtyre subjekteve, që të lejonte kryerjen e këtij veprimi. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** DRAKU dhe DPAKU të marrin masat e nevojshme, duke analizuar dhe vlerësuar mundësitë e investimit në blerjen e dhomave frigoriferike ose marrjes me qira të tyre, me qëllim që produktet, të cilat bllokohen gjatë inspektimit dhe që do të asgjësohen, të ruhen në këto ambjente. Nëse ky proces finalizohet, të sigurohen minimalisht 4 dhoma frigoriferike, pra 1 dhomë në dispozicion të 3 Qarqeve, më konkretisht dhoma frigoriferike për DRAKU Tiranë, të shërbejë edhe për DRAKU Elbasan dhe DRAKU Durrës, si dhe shërbimi i ruajtjes së produkteve të bllokuara në subjektet e inspektuara, t’u tarifohet atyre, deri në momentin e asgjësimit. Në këtë mënyrë çdo produkt, i cili bllokohet sipas përcaktimeve të Ligjit të ushqimit, nuk do t’i lihet në ruajtje subjektit, duke shmangur në këtë mënyrë edhe mundësitë, që produktit ta futet përsëri në treg.

#### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

<sup>4</sup> Shkronja g, pika 3 të Udhëzimit nr.14, datë 13.12.2012 “Mbi kriteret që duhet të plotësojë një laborator veterinar i autorizuar”.

<sup>5</sup> Rregullore e Komisionit dhe Parlamentit të BE-së -765-2008 – Akreditimi, Mbikqyrja e Tregut; Strategjia për mbrojtjen e konsumatoreve dhe mbikqyrjen e tregut, plani i veprimit, fusha-1.1.1-Siguria e produkteve Ushqimore.

**8.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të asgjësimit të produkteve, të cilave u ka kaluar afati i përdorimit ose kanë qenë të dëmtuara dhe nuk mund të konsumohen, është konstatuar se në **59 raste**, procedura e asgjësimit është kryer në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 69 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, pasi në këto praktika nuk administrohen dokumentet, të cilat vërtetojnë kryerjen e asgjësimit, si procesverbali i asgjësimit, i cili nënshkruhet nga të gjithë pjesëmarrësit në procedurën e asgjësimit (Inspektorët e tatimeve, Inspektorët e DRAKU dhe Inspektorët e ISHMPUT), dokumenti i transferimit të mbetjeve, sipas përcaktimit të bërë në pikën 4 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, në të cilin përcaktohen qartë detyrat për gjeneruesin e mbetjeve, transportuesin, pranuesin (pra personi përgjegjës në landfillin e Sharrës), referuar këtu edhe përcaktimeve ligjore të bëra në Kreun VIII të VKM nr.452, datë 11.7.2012 “Për lëndfilllet e mbetjeve”, i ndryshuar, kontrata e shërbimit ndërmjet gjeneruesit të mbetjeve dhe subjektit i cili ka kryer procedurën e shkatërrimit dhe transportimit të produkteve në landfill, fletë-dalja e produkteve nga magazina subjektit e firmosur nga magazinieri i saj si dhe foto të ngarkimit të produkteve në mjetet e shkatërrimit dhe dërgimit të tyre në landfill. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë, të marri masat e nevojshme, që çdo procedurë asgjësi, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë edhe: Procesverbali i asgjësimit i mbajtur nga inspektorët e tatimeve, mjedisit dhe ushqimit; Dokumenti i transferimit të mbetjeve; Fletë-dalja nga magazina e subjektit privat; Kontrata e shërbimit; Fatura tatimore e shërbimit, si dhe foto të ngarkimit të produkteve në makinën shkatërruese/transportuese sipas rastit deri në depozitim të tyre në landfill.

**Në vijimësi**

**9.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit (kryesisht atyre me ankesë/indicie), në të cilat sipas informacionit të pasqyruar në procesverbalet e inspektimit, është bërë bllokimi i produkteve ushqimore të ndryshme dhe linjës së prodhimit, është konstatuar se në **35 raste** nuk dokumentohet me shenjat dalluese dhe më pas administrimi i tyre për produktet, konkretisht për:

-27,890 kg mish, i ndryshëm;

-20,000 kg djath për praninë e vajit të palmës, për të cilin ka patur ankesë nga konsumator;

-20,525 kg yndyrë vegjetale, e shitur në treg si gjalp, për të cilën është lënë detyrë e tërheqjes nga tregu, por që nuk administrohet informacion se çfarë është bërë me këtë sasi;

-9,132 kg produkte të ndryshme (mocarela, briosh, djathra, etj);

-4,242 litra vaj të cilat janë shitur, ndërkohë që analizat laboratorike të këtij vaji, të kryera më pas, kanë dalë jashtë standardit, dhe ky vaj nuk u tërhoq nga tregu;

-587 kg yndyrë vegjetale e cila ishte shitur në treg si gjalp;

-516 cop pasta C;

-3 raste të bllokimit të aktivitetit/linjës së prodhimit.

Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 të nenit 40 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, shkronjën a të nenit 41, shkronjën ç të pikës 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat e nevojshme, që të pajisen me shenjat dalluese të bllokimit (shiritat ngjites për bllokimin e produkteve, plumbçe për bllokimin e aktivitetit/linjës së prodhimit, këtu mund t'i referoheni praktikës që ndjekin autoritetet doganore/Inspektorati Shtetor Teknik Industrial), me qëllim që në çdo praktikë bllokimi të përdoren shenjat dalluese dhe përdorimi i tyre të përcaktohet si detyrim ligjor në rregulloren e brendshme të institucionit.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**10.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit me qëllim licencimin e aktivitetit, në **11 raste** janë konstatuar mangësi dhe moszbatim i kuadrit ligjor përkatës, si vijon:

-Në 4 raste është bërë refuzimi i aplikimit të subjektit për licencim, për mosplotësim të kushteve teknike, por nuk është bërë edhe ndalimi i ushtrimit të aktivitetit, si dhe përcaktimi i afatit konkret për rregullimin dhe plotësimin e kushteve për licencim;

-Në 6 raste nuk dokumentohen veprimet e inspektorëve përgjatë verifikimit të kushteve teknologjike, higjenike si dhe të dokumentacionit të nevojshëm për licencim;

-Në 1 rast është miratuar aplikimi për licencim, ndërkohë që dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, ka patur mangësi në formë dhe përmbajtje, dhe për rrjedhojë aplikimi nuk duhej miratuar. Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjën “a” të nenit 92, nenin 680 dhe nenin 818 të Ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, i ndryshuar; pikën 3 të nenit 3 dhe nenin 19 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar; shkronjat ç dhe d të pikës 2 të nenit 4, pikat 2 dhe 3 të nenit 6 dhe pikën 2 të nenit 43 të Ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; pikën 2 të nenit 3, pikën 1 të nenit 5, si dhe shkronjat “a” dhe “b” të nenit 6 të Ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pikat 14 dhe 15, (licencimi i veprimtarive të nënkategorisë II.I.B), të VKM nr.538, datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar; shtojcën II të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 “Për miratimin e rregullores “për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, si dhe shkronjën b të nenit 49 të Rregullores së brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrisë përgjegjëse për bujqësinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**10.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që në çdo rast të refuzimit të aplikimit për licencim, të bëjë ndalimin e ushtrimit të aktivitetit si dhe përcaktimin e afatit konkret për rregullimin e mangësive.

**10.2.Rekomandimi:** Gjithashtu në çdo praktikë licencimi të administrohet aplikimi i subjektit, dokumentacioni i dorëzuar nga ai (cerifikata kualifikimi, certifikata cilësie, të higjenës, të pajisjeve etj), si dhe të dokumentohet me foto çdo verifikim i kryer në subjekt, për vlerësimin e plotësimit të kushteve për licencim.

**Në vijimësi**

**11.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **18 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve nga subjekti i inspektuar, si dhe në **29 raste** është konstatuar se në inspektimet, në të cilat është përcaktuar afati konkret për korrigjimin e shkeljeve, nga DRAKU Tiranë nuk është autorizuar inspektimi për verifikimin e korrigjimit të tyre, ku theksojmë se në këto praktika janë konstatuar edhe raste të trajtimit me dy standard (inspektimi për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve në subjektin “Y.M”, “A.F”, ose për subjekte të tjera është përcaktuar afati kohor i korrigjimit të shkeljeve (D, E.M, C, G), veprime dhe mosveprime që bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 4 dhe 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikën 16 të Kreut IV të Urdhrit nr.25, datë 10.08.2018 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

**11.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, që për ato raste në të cilat nuk është kryer verifikimi i korrigjimit të shkeljeve, të autorizohet inspektimi me qëllim verifikimin e tyre, si dhe në çdo inspektim, në të cilin konstatohet shkelje e ligjit, nga inspektorët të përcaktohet afat konkret për korrigjimin e tyre, si dhe subjekti të këshillohet për mënyrën e korrigjimit.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi**



**12.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të mostërmarrjes për analizë laboratorike, në **20 raste** është konstatuar se nga inspektorët nuk është dokumentuar plotësisht dhe saktësisht procedura e marrjes së mostrës në subjekt, ose nuk është marrë mostër me pretendimin se ISUV pranon mostra për analizë deri në orën 13:00, si dhe vendimi i inspektimit është marrë në të njëjtën ditë kur është marrë edhe mostra, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën B (1, 2, 3, 4) të Kreut II, pikën 3 të Kreut III dhe pikat 1 dhe 2 të shkronjës A, si dhe shkronjën “c” të pikës 1 të shkronjës B të Kreut IV të VKM nr.260, datë 27.3.2013 “Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave”, pikën 21 dhe pikën 30 të Kreut V të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018 “Për miratimin e rregullores “për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit”, Udhëzimit nr.107, datë 02.12.2002 “Për krijimin, shumëzimin, përpunimin, tregëtimin, kontrollin, vlerësimin e farave dhe fidanëve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor”. (Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.7) faqe (27-140 dhe 203-218) të Raportit të Auditimit)

**12.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë, të marri masat e nevojshme, që çdo procedurë mostërmarrje, të dokumentohet plotësisht, ku pjesë e dosjeve, të jenë: Autorizimi i inspektimit, listë-verifikimi, procesverbali standard i inspektimit, fletë-shoqërimi i mostrës në laborator, raport-prova, vendimi përfundimtar i inspektimit, i cili të merret në momentin e përgjigjes së rezultatit të analizës laboratorike.

**12.2.Rekomandimi:**Gjithashtu DRAKU në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme për pajisjen e inspektorëve me mjetet e nevojshme për marrjen e mostrës dhe transportimin e tyre në laborator.

#### **Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021 dhe në vijimësi**

**13.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **22 raste** është konstatuar se nga kryeinspektorët e DRAKU Tiranë, janë autorizuar inspektorë të sektorit të inspektimit të bimëve të kryejnë inspektime në subjekte, të cilat tregëtojnë produkte me origjinë shtazore, ose e anasjellta, pra jo sipas formimit profesional të tyre, dhe përfshirja e tyre në inspektime për llogari të një sektori tjetër brenda DRAKU Tiranë, bëhet me urdhër caktimi të Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, pasi vetëm ai ka kompetencën ligjore, për kryerjen e lëvizjeve, transferimeve, largimeve, caktimeve, etj, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në shkronjat a, b dhe c të pikës 4 të VKM nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, (në fuqi deri në 14.09.2020) si dhe shkronjën “g” të pikës 7 të Kreut III, të VKM nr.708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU-së”. (Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.7) faqe (27-140 dhe 203-218) të Raportit të Auditimit)

**13.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë, për çdo rast kur është e nevojshme përfshirja e një inspektori të një sektori të caktuar pranë drejtorisë (pra inspektori i sektorit të bimëve të kryejnë inspektime në subjekte që tregëtojnë produkte me origjinë shtazore ose e anasjellta), në kryerjen e inspektimeve për llogari të sektorit tjetër, t’i bëjë propozim Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, me qëllim miratimin nga ky i fundit, me urdhër caktimi të lëvizjes/transferimit paralel të inspektorit.

#### **Në vijimësi**

**14.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në **3 raste** është konstatuar se nga inspektorët e pikës kufitare Qafë Thanë dhe Durrës, është lejuar hyrja e produkteve ushqimore në Shqipëri (42 ton yndyrë vegjetale dhe 20 ton djath), ku dokumentet e praktikës së importit kanë patur mangësi në formë dhe përmbajtje, kryesisht (invoice, packing-list, certifikata veterinare, certifikata e analizave laboratorike), janë fotokopje, pa vulën e laboratorit përkatës dhe jo në gjuhën shqipe, mungesa e akt-kontrollit të inspektorëve, si dhe **në 1 rast**, në mënyrë të paligjshme janë zhbllokuar produkte importi të subjektit C, në mungesë të dokumentacioni

të origjinës (analiza e cilësisë), sipas urdhrit të ish-Drejtorit të Përgjithshëm të AKU, përcjellë me email-it, veprime dhe mosveprime në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 14, nenin 16, nenin 17 dhe 18, të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar; në Urdhrin nr.72, datë 15.03.2011 “Për miratimin e akt-kontrollit mbi inspektimin e produkteve me origjinë jo-shtazore në pikat e inspektimit kufitar dhe lejimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme për çdoganimin e tyre dhe akt-marrje mostre”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4 dhe 2.5) faqe (27-140 dhe 140-191) të Raportit të Auditimit)*

**14.1.Rekomandimi:** DPAKU, Sektori i Auditit të Brendshëm, ta marrë masat e nevojshme duke analizuar mundësitë për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve në 12 Drejtoritë Rajonale të AKU-së, me fokus shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së procedurës së inspektimit të produkteve të importit, ndjekur nga inspektorët e pikave kufitare, me qëllim identifikimin e mangësive, rregullimin e tyre dhe ngarkimin me përgjegjësi ligjore të personave përkatës, duke rritur në këtë mënyrë përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e punonjësve në institucion.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**15.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit, në 1 rast është konstatuar se nga Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, është nxjerrë urdhër i brendshëm për marrjen e mostrave në subjekte të cilat tregëtojnë fara dhe plehëra për përdorim për bimësi, në mungesë të kompetencës ligjore, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimin e bërë në nenin 109 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 dhe në pikën 2 të nenit 25, të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në RSH”, pikën 2 të nenit 24 të Ligjit nr.17/2020 “Për produktet plehëruese”, pikën 3 të shkronjës B të Kreut II, si dhe shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 4 të shkronjës B të Kreut II të VKM-së nr. 260, datë 27.03.2013 “Për caktimin e rregullave për kontrollin, marrjen e mostrave, analizave e të procedurave, dhënien e rezultateve të tyre, si dhe vlerësimin e analizave të plehrave”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.7) faqe (203-218) të Raportit të Auditimit)*

**15.1.Rekomandimi:** DPAKU në çdo rast kur e vlerëson të nevojshëm kryerjen e inspektimeve (përfshijtur ato të iniciuara nga ankesat/indiciet), jashtë planit vjetor të kontrollit zyrtar të miratuar nga Ministri përgjegjës për bujqësinë, të bëjë propozimin shoqëruar me relacionin shpjegues pranë MBZHR-së, dhe pritjen nga kjo e fundit të miratimit/refuzimit të propozimit, me qëllim shmangien e efekteve ligjore dhe financiare që mund të krijohen nga zbatimi i urdhrave të paligjshëm, si dhe duke forcuar në këtë mënyrë edhe elementët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në institucionin e AKU-së.

### **Në vijimësi**

**16.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të autokontrollit laboratorik, në 75 raste janë konstatuar mangësi, si më poshtë vijon:

-51 raste dokumentet standard nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve ligjore, kryesisht fletë-shoqërimi i mostrës nuk pasqyron informacionin për temperaturën e transportit të mostrës, paketimin e kampionit, orën e dorëzimit të mostrës, vendin e marrjes së mostrës, afatin e skadencës së produktit, raport-provat japin informacion për vendin e kampionimit të mostrës (Lot-in), origjinën e mostrës (import apo prodhim i brendshëm), kushtet e ruajtjes, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikat 3 dhe 6 të Urdhërit nr.24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit”;

-19 raste në analizat laboratorike ka marrë pjesë edhe përgjegjësja e laboratorit ku në të njëjtën kohë ka bërë edhe pritjen e mostrës në laborator, duke u bërë burim për konflikt interesi në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “b” (konflikt në dukje i interesit) të pikës 4 të nenit 3 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

-5 raste sasia e kampionit të sjellë për analizë nuk ka qenë në përputhje me përcaktimin ligjor të bërë në Urdhrin nr.24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit”, dhe në këto kushte mostrat nuk duhet të ishin

pranuar nga laboratorit<sup>6</sup>. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)

**16.1.Rekomandimi:** DPAKU të marri masat e nevojshme që për çdo rast, dokumentet standarde të laboratorit (autokontroll dhe kontroll zyrtar) të plotësohen saktë në formë dhe përmbajtje. Gjithashtu të mos lejohet marrja pjesë e përgjegjësitet të laboratorit në analizat laboratorike me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, si dhe në rastet kur sasia e kampionit të sjellë (autokontroll dhe kontroll zyrtar) nuk është sipas kërkesave teknike, mostra të refuzohet.

**Në vijimësi**

**17.Gjetje nga auditimi:** DRAKU Tiranë nuk ka kontabilizuar dhe pasqyruar në bilancin e vitit 2019, Godinën-3-kat të AKU Tiranë në vlerën 520,000 euro, në kundërshtim me udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, me ligjin ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)

**17.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të kontabilizojë dhe të pasqyrojë në bilancin financiar Godinën-3-kat të AKU Tiranë, bazuar në situacionin dhe akt kolaudimin përfundimtar të objektit.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

**18.Gjetje nga auditimi:** Sektori i OJSH-së së DRAKU Tiranë ka përdorur **2 standarde**, pasi: -për vitin 2018, në 2 raste, për prishje të shenjave dalluese të produktit të bllokuar, ka aplikuar gjobë maksimale 100,000 lekë (I shpk), ndërsa për raste tjera ka aplikuar gjobë minimale 10,000 lekë ( A.S dhe L.B),

-për vitin 2018, në 3 raste, nuk ka marrë mostra në OBU (H.Sh), ndërsa në disa tjera ka marrë mostra (K), në një kohë që janë konstatuar shkelje të njëjta.

-për vitin 2018, në 2 raste ka aplikuar diferencim të masës vendosjes gjobës, për etiketim parregullt, pasi ka vendosur gjobë minimale 50,000 lekë ndaj OBU “D”, ndërsa ka vendosur gjobë maksimale 100,000 lekë për OBU “E.M”, për shkelje njëjta.

-për vitin 2019, në 6 raste, ka vepruar me 2 standarde, lidhur me inspektimet me objekt të njëjtë “indice nga konsumatorët, rrjetet sociale dhe mediat etj”, pasi për disa subjekte kanë sjellë prova me foto të qarta (OBU “G”), ndërsa për disa raste tjera nuk kanë ilustruar faktet me foto, e domosdoshme për sqarimin sa më mirë të ankesave. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)

**18.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në të ardhmen të eliminojë inspektimet me 2 standarde, duke përdorur një standard inspektimi për gjitha subjektet, në zbatim të kërkesave ligjore, në mënyrë që të mos diskriminojë dhe diferencojë subjektet, të cilat shpesh janë bërë objekt ankesash dhe pakënaqësish ndaj inspektimeve të kryera.

**Në vijimësi**

**19.Gjetje nga auditimi:** Në DRAKU Tiranë për vitin 2019, u konstatuan:

- në **5 raste** çështje inspektimi të anuluar brenda ditës, megjithëse inspektimi ka filluar me kërkesën subjektit si: AKU-TR-2019-002706; AKU-TR-2019-002705; AKU-TR-2019-003059; AKU-TR-2019-003102; AKU-TR-2019-003101.

- në **3 raste** subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura, por nuk dokumentohet me foto, kërkesë kjo e rregullores së procedurës inspektimit, si: AKU-TR-2019-003182; AKU-TR-2019-000492; AKU-TR-2019-003151.

- në **1 rast** inspektimi tematik me objekt: “për zbatim urdhri eproreve” u konstatua se inspektimi nuk është argumentues dhe nuk shoqërohet me dokumente, informacion dhe foto, e

<sup>6</sup> Pika 4 e Kreut I të Urdhrin nr.24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit”.

domosdoshme kjo për raste të veçanta, madje nuk sqarohet pse lihet detyrë kur nuk pasqyrohet shkelja. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)

**19.1. Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marrë masa që inspektimet e filluara me kërkesën e subjekteve të mos anulohen pa arsye brenda ditës, në rast se subjektet e inspektimit gjenden të mbyllura të justifikohen me foto, sipas rregullores së procedurës inspektimit, si dhe shkeljet e konstatuara në inspektimet e kryera të shoqërohen me dokumente provuese, kryesisht në inspektimet tematike.

**Në vijimësi**

**20.Gjetje nga auditimi:** Në DRAKU Tiranë (sektori OJSH) për vitin 2020, u konstatuan:

-Në **5 raste**, inspektimet janë mjaftuar me paraqitjen e disa mangësive në godinën e subjekteve, si: mure, tavane, dysheme ose pjesë të tyre të dëmtuara dhe të pa lyera, sikur janë mbikëqyrës ose kolaudator ndërtimi, në vend që të trajtonin edhe sigurinë e produkteve ushqimore, gjurmimin, mostrat, analizat laboratorike, zbatimin e detyrave të lëna, arkëtimin e gjobave, dokumentacionin shoqëruar etj.

- Në **10 raste**, përgjigjet e analizave laboratorike për perime e fruta, për praninë e pesticideve pranë ISUV, kanë dalë me vonesë prej 3 muaj, çka ka humbur qëllimin e kryerjes të këtyre analizave, sepse perimet e frutat janë shitur plotësisht pasi nuk kanë qenë të bllokuara dhe nuk ka dalë përgjegjësia. Veprim ne kundërshtim me nenin 46/b të rregullores së brendshme AKU miratuar me urdhrin e Ministrit të Bujqësisë nr. 377 datë 05.09.2017 dhe me nenin 38/4 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.5) faqe (140-191) të Raportit të Auditimit)

**20.1. Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marrë masa që inspektimet të jenë të plota, të trajtojnë të gjitha problemet e legjislacionit dhe jo duke u mjaftuar vetëm me kushtet higjieno-sanitare, gjendjen e godinave dhe ambjenteteve tyre, të cilat përfaqësojnë një pjesë të inspektimit.

**20.2. Rekomandimi:** Gjithashtu të merren masat e nevojshme që përgjigjet e analizave laboratorike për perime e fruta, për praninë e pesticideve pranë ISUV, të sigurohen brenda afatit ligjor dhe pa vonesa me qëllim që të garantohet siguria ushqimore e produkteve të bllokuara, sipas kërkesave të nenit 46/b të rregullores brendshme AKU miratuar me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr.377 datë 05.09.2017 dhe me nenin 38/4 të ligjit nr. 10433 datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

**Në vijimësi**

**21.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të marrjes së mostrave për produktet PMB rezulton se nuk është kryer analizimi në vitet 2018-2019, nga laboratorit i akredituar siç parashikohet në ligjin 105/2016 kreu II, pika 1.2, germa a,b dhe c. Moskryerja e analizimit ka bërë të mundur që PMB-t për përdorim në vendin tonë nuk i nënshtrohen asnjë analize laboratorike të formulimit për të parë vetitë e tyre fiziko – kimike, përbërjen e lëndës vepruese dhe përmbajtjen e saj në % apo g/L, përbërjen dhe përmbajtjen e lëndëve mbushëse (inerte) si dhe përbërjen e aditivëve që ju shtohen formulimeve. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit)

**21.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marrin masat e nevojshme, për analizimin e produkteve PMB, duke përgatitur Planin Kombëtar të Kontrolleve Zyrtare me bazë risku dhe të marrjes së mostrave për ushqimin, ushqimin për kafshë, mbrojtjen e bimëve dhe inuteve bujqësore, si dhe planin e marrjes së mostrave në PIK, para hartimit të buxhetit të ISUV për të parashikuar nevojën për reagent dhe standartet e nevojshme për hartimin e tyre.

**Menjëherë**

**22.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit në **15 raste** inspektorët nuk kanë bërë plotësimin e listë-verifikimit në mospërputhje me pikën 3 neni 45, të ligjit nr.10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe me urdhërin nr.13, datë 23.04.2015 “Për Miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit)

**22.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të bëj plotësimin e listë-verifikimit për të gjithë inspektimet, si dhe në rastet kur subjektet kanë mungesë të produkteve, të bëhën komentet në kategorinë përkatëse.

**Menjëherë**

**23.Gjetje:** Nga DPAKU nuk është respektuar përcaktimi ligjor në pikën 2, të nenit 10 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, për hartimin dhe miratimin e metodikës për përcaktimin e vlerës së gjobës, si dhe nuk është hartuar manuali i posaçëm i inspektimit, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në Urdhrin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 13, datë 23.4.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**23.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së përcaktimit të vlerës së gjobës, ku gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës për llojin e shkeljes, të merret në konsideratë historiku dhe frekuenca e shkeljeve të subjektit në vitin paraardhës, me qëllim shmangien e qëndrimit subjektiv të inspektorit në përcaktimin e masës së gjobës përballë shkeljeve të subjektit.

**23.2.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e manualit posaçëm të inspektimit, referuar këtu edhe përcaktimeve të bëra në manualin e përgjithshëm të inspektimit në RSH<sup>7</sup>.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

**24.Gjetje:** Rregullorja e brendshme e DRAKU Tiranë nuk përputhet me ndryshimet strukturore të AKU-së, sipas VKM nr.708, datë 09.09.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e autoritetit kombëtar të ushqimit”, ku ndër të tjera është parashikuar edhe pozicioni i përgjegjës të sektorit të inspektimit pranë DRAKU, pozicioni i cili më përpara nuk ka qenë i parashikuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**24.1.Rekomandimi:** DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat për hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të AKU-së, ku veç të tjerave të përcaktohet afati konkret për shqyrtimin e ankesave/indikieve që vijnë nga konsumatorët, grupe interesi. Gjithashtu në Kreu-n përkatës të kësaj rregullore, të përcaktohen rregulla të qarta për sektorin e laboratorit, mbi administrimin e mostrave (për të shmangur edhe konfliktin e interesit), dokumentet standard që duhet të përdoren, etj.

**24.2.Rekomandim:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU si edhe me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat e nevojshme, për ngritjen e një grupi të përbashkët pune, për hartimin dhe miratimin e rregullores së procedurës së arkëtimit të gjobës nga momenti i vënies së gjobës nga inspektorët, ankimi, shqyrtimi i ankimit nga komisioni përkatës, përcjellja e vendimit nga DPAKU-DRAKU ose MBZHR-DPAKU-DRAKU, masat që duhet të merren nga DRAKU për vënien në ekzekutim si dhe monitorimin periodik të veprimeve të ndërmarra nga përmbauesit për ekzekutimin e detyrimit.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

**25.Gjetje:** Në Urdhërin nr.24 datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorëve”, nuk ka afate të përcaktuara për nxjerrjen e rezultatit të analizave laboratorike, duke sjellë vonesa në përgjigjen e tyre nga 5-15 ditë për të nxjerrë rezultatit, ç’ka në gjykimin e grupit të auditimit mund të ndikojë negativisht në aktivitetin e subjektit privat, pasi ky i fundit do të jetë i detyruar të mos tregëtojë produktin, deri në pritjen e rezultatit të analizës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

**25.1.Rekomandimi:** DPAKU në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, të marrin masat e nevojshme, që në Urdhërin e mësipërm, të përcaktohet afati minimal dhe maksimal i nxjerrjes

<sup>7</sup> Urdhri nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.

së rezultatit laboratorik, të përcaktohen kushtet teknike për pranimin e mostrave për analizat fiziko-kimike.

**Brenda 6 mujorit të dytë të vitit 2021**

## **C.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit autorizues), të merren masa e të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohen në rrugë administrative dhe ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kthimin e ligjshmërisë dhe kërkimin për shpërblimin e dëmit të krijuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën **4,146,175 lekë**, si më poshtë:

**1.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të shqyrtimit të ankesave nga Komisioni përkatës pranë DPAKU, është konstatuar se në 3 raste për subjektet (L.X – 1,300,000 lekë, R.C – 700,000 lekë, I – 1,150,000 lekë) janë shfuqizuar gjambat e vendosura nga inspektorët e DRAKU Tiranë, për të cilat Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përkatësisht nr.1220, datë 23.06.2020, nr.400, datë 08.06.2020 dhe nr.339, datë 10.03.2020, i kanë lënë në fuqi, *duke krijuar të ardhura të munguara me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 3,150,000 lekë*. Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 2 të nenit 65 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.10) faqe (254-266) të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të përcjellin pranë zyrave të përmbartimit, vendimet e mësipërme të Gjykatës, me qëllim vënien në ekzekutim dhe arkëtimin e gjobave në vlerën **3,150,000 lekë**.

**Menjëherë**

**2.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të ekzekutimit të gjobave, është konstatuar se në 2 raste për një periudhë rreth 2.4 - 2.5 vjeçare, nga momenti i vendosjes së gjobave, nuk është marrë asnjë masë për ekzekutimin dhe arkëtimin, **duke sjellë parashkrimin e tyre**, sipas nenit 46 të Ligjit nr.10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, dhe heqjen e të drejtës për arkëtimin nga AKU, *me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350,000 lekë*. Këto mosveprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në nenin 9, pikën 1 të nenit 30, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30, pikën 1 të nenit 41 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; nenin 91 pika 1, nenin 97 pikat 1, 2, 3, nenin 128 pika 1 dhe pika 3, nenin 133 pika 3 shkronja a, nenin 138 pika 1, nenin 140 pika 1 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, nenet 510 dhe 511 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pikën 4 të nenit 9, pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, pikën f të nenit 42 të Rregullores së Brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë, pikat 11, 14 dhe 16 të Urdhrit nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim” dhe pikat 1, 2, 3 dhe 5 të Urdhrit nr.1586, datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për ndjekjen e procedurave ligjore në gjykatat administrative, për vjeljen e gjobave të vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm gjykatë rrethi”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**2.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjyqimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën **350,000 lekë**, përkatësisht

nga personat përgjegjës, pasqyruar në tabelën nr.31, në Kap., Anekse, aneksi nr.7, Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### Menjëherë

**3.Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me UMF nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, DRAKU Tiranë nuk ka përllogaritur dhe ndalur tatimin mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë (1,842,171 x 15 %) ndaj E.Sh, pagë e përfituar sipas urdhër shpenzimit nr.82 datë 13.05.2020 mbi bazën e Vendimit Gjykatës së Apelit nr.3320 datë 20.12.2019. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-22) të Raportit të Auditimit)

**3.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marrë masa për arkëtimin e tatimit mbi të ardhurat për vlerën 276,325 lekë ndaj E.Sh, pasi nuk është ndalur nga paga e përfituar, sipas urdhër shpenzimit nr.82, datë 13.05.2020 dhe Vendimit Gjykatës Apelit nr. 3320 datë 20.12.2019.

### Menjëherë

**4.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të likuidimit të gjobave, është konstatuar se në **2 raste** nga përmbaruesit gjyqësor nuk është ekzekutuar plotësisht detyrimi monetar i subjektit të gjobitur, pasi është paguar vetëm vlera e gjobës dhe jo edhe kamat-vonesa (2% e vlerës së gjobës), me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën 266,000 lekë, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të nenit 30 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)

**4.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 266,000 lekë, përkatësisht nga përmbaruesi gjyqësor privat z.R.A.

### Menjëherë

**5.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të likuidimit të gjobave të vendosura nga DRAKU Tiranë, në **1 rast**, është konstatuar, se nuk është arkëtuar vlera e kamat-vonesës, për arsye se, nga DRAKU Tiranë, në kërkesën e bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nuk është kërkuar edhe arkëtimi i kamat vonesës, në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 3 të nenit 30 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, pikën 4 të nenit 9, pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Kreun IV, nenin 65 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodit të Procedurës Civile në RSH”, i ndryshuar, shkronjën “f” të nenit 42 të Rregullores së Brendshme miratuar me Urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr. 377 datë 05.09.2017, dhe si pasojë e mosvprimeve janë krijuar të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 48,000 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.6) faqe (191-203) të Raportit të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, për vlerën 48,000 lekë, nga zyra përmbaremore e ngarkuar me ekzekutimin e detyrimit.

### Menjëherë

**6.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të likuidimit të analizave laboratorike të kryera në laboratorin e DRAKU Tiranë, është konstatuar se, në 9 raste, si pasojë e mangësive (tarifim më pak se vlera e përcaktuar) janë krijuar të ardhura të munguara me efekt dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 23,750 lekë, në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në pikën 3 të nenit 12 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.8, datë 8.05.2007 “Mbi tarifatat e të ardhurave dytësore të aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë”, pikën 61 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i

ndryshuar, Udhëzimin nr.1 prot., datë 09.01.1996 “Per procedurat e punes se sistemit te thesarit dhe marredheniet me institucionet buxhetore”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.8) faqe (218-255) të Raportit të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:**DRAKU Tiranë të marri masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën 23,750 lekë*, përkatësisht nga 9 subjektet që kanë përfituar shërbimin e analizës laboratorike, pasqyruar në tabelën nr.32, Kap., Anekse, aneksi nr.7.

**Menjëherë**

**7.Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin”, DR AKU Tiranë nuk ka administruar në magazinë, nuk ka prerë fletë-hyrje për 23 kg mish të bllokuar/sekuestruar me vlerën 16,100 lekë, për pasiguri ushqimore, pa vulë veterinerit, pa certifikate, pa kushte përshtatshme si dhe mjete prerëse, ku nuk përcaktohet numri dhe vlera e tyre, për të cilat nuk administrohet asnjë dokument, konkretisht:

a.sipas inspektimit datë 23.10.2019 në subjektin (S.V), Kavajë, DRAKU Tiranë nuk ka bërë hyrje 23 kg produkte mishi për vlerën 16,100 lekë *(çmimet minimale tregut)* për pasiguri ushqimore, pa vulë veterinerit dhe pa certifikate, si dhe mjete prerëse të pa përcaktuara numri i tyre, ku sipas procesverbalit të inspektimit, janë ngarkuar në automjetin e institucionit me targa AA691XI dhe janë dërguar në ambientet e DRAKU Tiranë, por mungon fletë-hyrja në magazinë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar Ushqimit Tiranë, sektori i financës të arkëtojë vlerën 16,100 lekë për 23 kg mish të pa administruar në magazinën e institucionit, bllokuar/sekuestruar për pasiguri ushqimore, në ngarkim të Z.C, E.C dhe A.N me nga 5,366 lekë/secili.

**Menjëherë**

**8.Gjetje:** Nga auditimi i praktikave të inspektimit, është konstatuar se në **2 raste** nga inspektorët në vendimin përfundimtar, nuk është vendosur detyrimi për likuidimin e shpenzimeve të analizës laboratorike (në vlerën 4,500 lekë), mosveprime të cilat bien në kundërshtim me përcaktimin ligjor të bërë në pikën 5 të nenit 38, të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, duke hequr mundësinë e arkëtimin të tyre, *me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën 9,000 lekë* (vlera e analizës). *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.4) faqe (27-140) të Raportit të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore dhe shkallët e gjykimit, për arkëtimin e të ardhurave të munguara me efekt dëm ekonomik në buxhetin e shtetit, *për vlerën 9,000 lekë*, përkatësisht nga z.N.H dhe z.A.N, inspektor 4,500 lekë secili.

**Menjëherë**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimeve bankës në DR AKU Tiranë u konstatua: Sipas urdhër shpenzimeve nr.29, 30, 31, 32, 33, 34 datë 70.02.2020 dhe nr.76 datë 13.05.2020 DRAKU Tiranë ka likuiduar ndaj DRSHTRR Tiranë vlerën 7,000 lekë gjoba, për tejkalim afati për kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën (2.3) faqe (22-27) të Raportit të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë të arkëtojë vlerën 7,000 lekë gjoba, për tejkalim afati për kontrollin vjetor teknik të 7 automjeteve, përkatësisht A.N dhe N.C me nga 3,500 lekë/ secili.

**Menjëherë**



## **C.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.**

**1.Gjetje:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të DRAKU Tiranë, në vija të përgjithshme është konstatuar se ky institucion paraqet problem në ndjekjen dhe arkëtimin e gjobave të akumuluar nga viti 2014 deri në vitin 2019 për vlerën 290,232,981 lekë, sipas bilancit 2019, ç'ka e ka bërë jo efektive punën e këtij institucioni. Më konkretisht nga auditimi i praktikave të arkëtimit të gjobave të vendosura nga inspektorët është konstatuar se:

-Në **56 raste** nga DRAKU Tiranë, DPAKU si dhe nga përmbauesit gjyqësor të ngarkuar për ekzekutimin e gjobave, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme (shyrtimi i ankesës brenda afatit ligjor, njoftimi i subjekteve për likuidim vullnetar, kërkimi nga përmbauesit që të përdorin të gjitha mjetet ligjore për ekzekutimin e gjobave, ndjekja në mënyrë periodike e arkëtimit të tyre, sekuestrimi i sendeve të paluajtshme/të luajtshme) dhe për pasojë deri në momentin e auditimit nuk janë arkëtuar në buxhetin e shtetit gjobat në vlerën 29,958,000 lekë, ku theksojmë se nga 56 rastet e mësipërme, janë 23 gjoba, përkatësisht në vlerën 18,334,000 lekë gjithsej, për të cilat është bërë ankim prej rreth 1.7-2 vite, dhe ende nuk janë shqyrtuar, duke rritur mundësinë e parashkrimit të tyre.

-Në **2 raste** për gjobat që **nuk janë arkëtuar akoma**, dhe që **janë në proces**, në kërkesën e drejtuar GJSHP Tiranë për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, nuk janë kërkuar për arkëtim edhe kamat-vonesat në vlerën **86,000 lekë**. Këto mosveprime bien në kundërshtim me nenin 140 të Ligjit nr.44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; nenin 9, pikën 3 të nenit 30, nenet 31, 33, 35, 36 të Ligjit nr.10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenin 32 të Ligjit nr.10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, shkronjën e të pikës 4 të Kreut III të VKM nr.1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, të ndryshuar, kreun V të VKM nr.417, datë 27.5.2020 “Për procedura te organizimit dhe të funksionimit të komisionit për shqyrtimin e masave administrative në ministrinë përgjegjëse për ushqimin”, nenin 34 të Kreut 3 të Urdhrit nr. 25, datë 10.8.2018 për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ”, pikën f të nenit 42 të Rregullores së Brendshme të AKU-së, miratuar me urdhrin nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrit përgjegjës për bujqësinë, si dhe pikat 11, 14 dhe 16 të Urdhrit nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për procedurat e vendosjes së gjobave, evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim”. *(Më hollësisht trajtuar në pikat (2.4, 2.5 dhe 2.6) faqe (27-140; 140-191 dhe 191-203) të Raportit të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** DRAKU Tiranë në bashkëpunim me DPAKU, të marri masat e nevojshme duke identifikuar dhe vlerësuar, rast pas rasti ecurinë e arkëtimit të gjobave, të cilat janë në proces shqyrtimi ose ekzekutimi nga përmbauesit gjyqësor privat, si dhe të kërkojë nga këta të fundit ezaurimin e të gjitha mjeteve ligjore (sekuestrim të sendeve të luajtshme/paluajtshme), për ekzekutimin e detyrimeve monetare (gjobë+kamat-vonesa). Për çdo rast, kur nga përmbauesit nuk merren të gjitha masat e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit, DPAKU t'i drejtohet Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim që nga kjo e fundit të aplikohen penaltitetet ndaj përmbauesve. Në këtë mënyrë, kjo praktikë do të shërbejë për rritjen e përgjegjshmërisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit të AKU me zyrat e përmbauesve.

-Për dy rastet, në të cilat nuk është kërkuar për arkëtim kamat-vonesa, të njoftohet shërbimi i përmbauesve për arkëtimin e tyre, duke shmangur dëmin ekonomik që mund të shkaktohet ndaj buxhetit të shtetit, në të ardhmen.

-Gjithashtu 23 gjobat në vlerën 18,334,000 lekë, t'i përcillen për shqyrtim dhe vendimmarrje Komisionit të DPAKU-së ose Komisionit të posaçëm në MBZHR, sipas kompetencës ligjore.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** DRAKU Tiranë për vitet 2018-2019-2020 ka likuiduar 3 vendime gjyqësore për largime nga puna, sipas urdhër shpenzimeve nr.46 datë 13.03.2018, nr.82 datë

13.05.2020, nr.177 datë 03.10.2018, nr.215 datë 21.11.2018, nr.186 datë 11.11.2020, ku është konstatuar: se nuk janë nxjerrë përgjegjësitë dhe nuk janë marrë masa administrative ndaj ish-Kryeninspektorit të DRAKU Tiranë z.F.S dhe ish Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së z.A.I, pasi me veprimet e tyre ndaj buxhetit të shtetit është shkaktuar efekt negativ financiar në vlerën 3,531,426 lekë (pagesë e dubluar për të njëjtën vend pune dhe periudhë, për inspektorin zëvendësues dhe për inspektorin e larguar i cili e ka fituar me vendim gjykatës Apelit). Veprime në kundërshtim me pikën 62 e UMF nr.2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” dhe me urdhrin e Ministrit Bujqësisë nr.442, datë 04.03.2020 dhe nr.995, datë 15.06.2020. (Më hollësisht trajtuar në pikën (2.2) faqe (20-22) të Raportit të Auditimit)

**2.1.Rekomandimi:** DPAKU të marrë masa për shqyrtimin e përgjegjësive dhe vendosjen e masave administrative ndaj personave ish-drejtues të AKU, pavarësisht se ata janë larguar në vende pune tjera, *pasi kanë shkaktuar efekte negative financiare në buxhetin e shtetit për vlerën 3,531,426 lekë*, si rezultat i largimeve të punonjësve nga puna pa u bazuar në legjislacionin në fuqi, sipas Vendimeve Gjykatës Apelit.

**Menjëherë**

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D.1. PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHENIE PUNE**

#### **D.1.1. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës.**

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kontratën individuale të punës, i kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të AKU-së, vlerësimin dhe marrjen masave të nevojshme rast pas rasti, sipas shkëlqeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore:

#### **“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Ndërprerje të kontratës së punës”, për:**

- z.A.N, me detyrë Inspektor, (ish Kryeinspektor i komanduar i DRAKU Tiranë, për periudhën Tetor 2019 – Maj 2020), për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, (administrimi i sendeve të sekuestruara, fq.,24-25; për mosrealizim të planit të inspektimeve për muajt Tetor-Dhjetor 2019 dhe Janar-Shkurt 2020, fq.,29; 2 raste të gjobave që janë parashkruar, fq.,32-33; si dhe 13 praktika inspektimesh, fq., 30, 33, 35, 63, 72, 87, 91, 116, 136, 138.
- z.G.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 33, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 48, 50, 51, 57, 59, 117, 120, 134.
- z.Z.C, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 14 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 30, 33, 35, 63, 72, 87, 91, 116, 136, 138.
- z.N.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 15 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 35, 36, 37, 38, 39, 41, 42, 43, 44, 59, 70, 72, 83, 85, 137.
- z.E.V, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 23 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 36, 37, 38, 39, 43, 44, 56, 57, 73, 84, 117, 125, 127, 136, 138, 159, 163, 165, 167, 181, 208, 254.
- z.E.M, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 18 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 46, 57, 93, 124, 125, 127, 128, 134, 151, 156, 160, 163, 167, 209.
- z.D.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 15 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 37, 39, 41, 42, 43, 44, 58, 86, 92, 121, 171, 176, 178, 194, 207.
- zj.F.V, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Laboratorit në DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në dokumentacionin e administruar në praktikat e analizave të autolaboratorit, si raport-provat, fletë-shoqërimi i mostrave, sasia e kampionit të mostrës-jo në përputhje me përcaktimet ligjore të bëra në Urdhërin e Ministrit të Bujqësisë nr.24, datë 30.01.2013 “Për unifikimin e procedurave, metodave, dhe dokumentacionit të funksionimit të laboratorit”, Udhëzimin e Ministrit të Bujqësisë nr.8, datë 8.05.2007 “Mbi tarifat e të ardhurave dytësore të

aplikueshme nga institucionet vartëse të Ministrisë së Bujqësisë”, trajtuar në pikën 2.8, fq., nr.218-255 të Raportit të Auditimit;

**“Vërejtje” deri “Vërejtje me paralajmërim”, për:**

- z.A.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 73, 101, 103, 106, 163, 170, 173, 176, 178, 207.
- zj.E.SH, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 58, 60, 72, 73, 86, 93, 164, 176, 178.
- z.E.C, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 58, 60, 72, 73, 86, 93, 164, 176, 178.
- z.T.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 191, 191, 196, 198, 199, 200, 208.
- z.L.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 33, 56, 103, 131, 154, 155, 158, 163, 173, 176, 178, 206.
- zj.Sh.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 9 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 36, 54, 60, 67, 69, 80, 88, 91, 134.
- z.D.D, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 48, 51, 52, 57, 104, 117, 125, 155, 164, 173, 254.

**Vërejtje, për:**

- z.M.K, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 59, 72, 73, 116, 125, 148.
- zj.S.L, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 32, 64, 71, 107, 157, 163, 167, 182.
- zj.L.A, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 92, 97, 109, 155, 158.
- zj.A.H, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 50, 54, 61, 67, 96, 97.
- zj.M.B, me detyrë Inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 raste gjithësej, në praktika inspektimesh, trajtuar në fq., 48, 64, 107, 157, 172, 254.

➤ Për punonjësit, të cilët janë konstatuar në më pak se 5 raste, nuk propozojmë masë disiplinore, **por tërheqje vëmendje**, për kryerjen e funksioneve në vijimësi, si më poshtë vijon:

- z.M.N, me detyrë Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Korrik-Dhjetor 2020, periudhë brenda vitit 2020, të cilën lidhur me inspektimet e kemi marrë me rezervë, për shkak të pandemisë Covid-19, si dhe angazhimit të inspektorëve të DRAKU, me grupe inspektimi të përbashkëta për monitorimin e zbatimit të masave anti Covid-19, pasqyruar në fq., nr.15 dhe 29;
- zj.N.C, me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës;
- zj.H.P, me detyrë jurist;
- zj.S.Rr, me detyrë inspektor;
- z.V.S, me detyrë inspektor;
- zj.K.S, me detyrë inspektor;
- zj.M.C, me detyrë inspektor;
- z.A.H , me detyrë inspektor;
- zj.A.Sh, me detyrë inspektor;
- zj.E.D, me detyrë inspektor;
- zj.E.Gj, me detyrë inspektor;
- z.L.Z, me detyrë inspektor;
- zj.H.K, me detyrë inspektor;
- zj.F.F, me detyrë inspektor;
- z.Gj.P, me detyrë inspektor;
- z.E.C, me detyrë inspektor;
- zj.F.B, me detyrë inspektor;

- zj.M.A, me detyrë inspektor;
- z.V.V, me detyrë inspektor;
- zj.D.K, me detyrë inspektor;
- z.E.M, me detyrë inspektor;
- zj.H.H, me detyrë specialiste laborator;
- z.N.H, me detyrë inspektor;
- z.P.D, me detyrë inspektor;
- z.A.K, me detyrë inspektor;
- zj.E.Sh, me detyrë inspektor;
- z.I.O, me detyrë inspektor;
- zj.M.K, me detyrë inspektor;
- z.F.M, me detyrë inspektor;
- zj.P.R, me detyrë specialiste e magazinës;
- z.R.M, me detyrë inspektor;

## **D.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Ndërpriërie të kontratës së punës”** për:

- zj.M.M, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 60 raste;
- z.S.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 48 raste;
- z.F.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për të meta dhe mangësi në 33 raste;

### **“Vërejtje” deri “Vërejtje me paralajmërim”:**

- z.L.B, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 11 praktika inspektimesh;
- zj.M.B, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 11 praktika inspektimesh;
- zj.V.Zh, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 praktika inspektimesh;
- zj.Y.A, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 10 praktika inspektimesh;

### **Vërejtje:**

- zj.L.Zh, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 praktika inspektimesh;
- z.B.O, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 7 praktika inspektimesh;
- zj.N.M, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 praktika inspektimesh;
- zj.M.D, me detyrë inspektor, për të meta dhe mangësi në 6 praktika inspektimesh;

## **E. KALLËZIM PENAL**

Bazuar në nenin 281 “Kallëzimi nga nëpunësit publikë” të Ligjit nr.7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (për veprime në kundërshtim me nenin 248 “shpërdorimi i detyrës” të Ligjit nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar), sugjeroj trajtimin e detajuar tekniko-juridik nga ana e Departamentit Juridik të materialeve të evidentuara nga grupi i auditimit në kuptim të referencave të Kodit Penal, për personin si më poshtë:

**E.I.1.z.S.S, ish Kryeinspektor i DRAKU Tiranë, për periudhën Maj – 15 Tetor 2019.**

### **E.I.Veprimet dhe mosveprimet e z.S.S, ish-Kryeinspektor i DRAKU Tiranë për periudhën Maj – 15 Tetor 2019, për rastet e trajtuara më poshtë, bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore të bëra në:**

-Nenin 510 dhe 511 të Ligjit nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Nenin 9, shkronjën b të pikës 4 të nenit 30 dhe nenin 46 të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Pikën 11, 14 dhe 16 të Urdhrit nr.4277, datë 01.12.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për procedurat e vendosjes së gjobave,

evidentimit, administrimit dhe ndjekjes për arkëtim”, Pikën 1, 2, 3 dhe 5 të Urdhrit nr.1586, datë 28.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm “Për ndjekjen e procedurave ligjore në gjykatat administrative, për vjeljen e gjobave të vendosur nga DRAKU të cilat kanë vetëm gjykatë rrethi”, **për rastin nr.1, më poshtë;**

-Shkronjën “a” të pikës 8/2 të VKM nr.1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, të ndryshuar dhe VKM nr.1344, datë 10.10.2008 “Për etiketimin e produkteve ushqimore”, **për rastin nr.2, më poshtë;**

-Pikën 5 të nenit 48 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, **për rastet nr.3 dhe 4, më poshtë;**

-Pikën 1 të nenit 68 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar; Nenin 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 288, shkronja “ç” të Ligjit nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ndryshimet e ligjit nr.44/2019, datë 18.7.2019, botuar në fletoren zyrtare më datë 27.09.2019), **për rastet nr.4, 4.1<sup>8</sup>, më poshtë;**

-Shkronja “d”, pika 5, të VKM nr.1081, datë 21.10.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, të ndryshuar, **për rastin nr.4.2, më poshtë;**

-Shkronjat a, b dhe c të pikës 4 të VKM nr.1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, të ndryshuar, për rastin nr.5, më poshtë.

### **Më konkretisht rastet:**

**1.**Për mosmarrjen e masave për vënien në ekzekutim në **dy raste të gjobave** të vendosura ndaj subjekteve “F.P” dhe “M.A.S” (subjekte të cilat nuk kanë bërë ankim administrativ të gjobave të vendosura), duke sjellë **parashkrimin e tyre**, me pasojë dëm ekonomik i shkaktuar ndaj buxhetit të shtetit në vlerën 350 mijë lekë gjithësej. *(Trajtuar më hollësisht në pikën (2.4) të Raportit të Auditimit, praktikat e inspektimit nr.4 dhe 7, në faqet 32-35)*

**2.**Për nxjerrjen e autorizimit nr.AKU-TR-2019-006160-1, datë 27.09.2019, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “a” të pikës 8/2 të VKM nr.1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, të ndryshuar, për zhbllokimin e 45 ton yndyrë vegjetale, në subjektin “K.F.T”, (bllokuar në inspektimin e mëparshëm nr.AKU-TR-2019-002774-1, datë 15.05.2019), me arsyetimin se është bërë notifikimi i etiketës, ndërkohë që detyrimi i notifikimit të etiketës, nuk ishte lënë në inspektimin e mëparshëm, dhe të shërbente si arsyetim për nxjerrjen e autorizimit për inspektimin e rradhës, për zhbllokimin e sasisë së bllokuar. Theksojmë se ky është një produkt importi, dhe informacioni i tij jepet në gjuhën shqipe në etiketën origjinale ose në kundëretiketë, pra nuk duhet të bëhet notifikimi i etiketës, veprim të cilin VKM nr.1344, datë 10.10.2008, nuk e parashikon në asnjë përcaktim ligjor. Për më tepër, në zbatim të përcaktimit ligjor të bërë në pikën 1 të nenit 12 të VKM nr.1344, datë 10.10.2008, informacioni që deklarohet në etiketë, duhet që ta shoqërojë produktin ushqimor gjatë gjithë kohës, ose të dërgohen paraprakisht/njëkohësisht me dërgesën e tij, dhe kjo duhet të garantohet nga operatori i biznesit, gjë e cila nuk është bërë. Për sa më sipër nuk duhet të ishte nxjerrë autorizimi nga Kryeinspektori. *(Trajtuar më hollësisht në pikën (2.4) të Raportit të Auditimit, praktikat e inspektimit nr.24 dhe 25, në faqet 52-55).*

**3.**Për mosnxjerrjen e autorizimit të inspektimit për subjektin “G”, me qëllim verifikimin e korigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 07.06.2019, për tërheqjen nga tregu të sasisë 20,525 kg produktit f.b (produkt ushqimor i pasigurt), të shitur dhe rietiketimin e saj, si dhe mosnxjerrjen e autorizimit të inspektimit për subjektin “P.T.C”, me qëllim verifikimin e korigjimit të shkeljeve të lëna brenda afatit 16.08.2019. *(Trajtuar më hollësisht në pikën (2.4) të Raportit të Auditimit, praktikat e inspektimit nr.40 dhe 72, në faqen 68 dhe faqet 92-93).*

**4.**Për mosnxjerrjen e autorizimit të inspektimit për verifikimin e korigjimit të shkeljeve në inspektimin e subjektit “O.C.K.E”, **brenda datës 14.08.2019;**

<sup>8</sup> Në mbështetje të pikës 1 të nenit 68 të Ligjit nr.9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, i ndryshuar, dhe në nenin 54 të Ligjit nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ku në rastet kur shkeljet e kërkesave ligjore nuk përbëjnë vepër penale, **por që në këtë** rast gjen mbështetje sipas përcaktimit ligjor të bërë në nenin 288, shkronja “ç” të Ligjit nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ndryshimet e ligjit nr.44/2019, datë 18.7.2019, botuar në fletoren zyrtare më datë 27.09.2019).

**4.1.** Për moskryerjen e kallëzimit penal ndaj këtij subjekti, i cili nuk ka respektuar detyrimin (lënë nga Inspektorët e DRAKU Tiranë me Vendimin e ndërmjetëm nr.AKU-TR-2019-004906-4, datë 01.08.2019, për marrjen e masës urgjente, ndërprerjes së aktivitetit deri në plotësimin e kushteve-higjieno sanitare dhe pajisjes me licencë II.1.A.1), por ka vazhduar ushtrimin e aktivitetit normalisht; *(Trajtuar më hollësisht në pikën (2.4) të Raportit të Auditimit, praktika e inspektimit nr.90, në faqet 108-110).*

**5.**Për nxjerrjen e Urdhër caktimeve në 5 raste, që inspektorë të sektorëve të ndryshëm (sektori i bimëve, apo i pikës kufitare Rinas), të kryejnë inspektime për llogari të një sektori tjetër, në mungesë të kompetencës ligjore, pasi këtë të drejtë e ka vetëm Drejtori i Përgjithshëm i DPAKU. *(Trajtuar më hollësisht në pikat (2.4 dhe 2.5) të Raportit të Auditimit, praktikat e inspektimit nr.42, 65, 66, 72, në faqet 68-69, 85-86, 92-93, si dhe praktika nr.10, faqe nr.157).*

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.

---

**K R Y E T A R**

**Arben SHEHU**